V E N D I M
Nr.256, datë 17.10.2001

PËR SHPALLJEN E REZULTATIT TË ZGJEDHJEVE PËR KRYETARIN E KOMUNËS SË GOLAJT TË QARKUT TË KUKËSIT

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, asistuar nga sekretarja Merita Dulaku, në mbledhjen e tij të datës 17.10.2001, me pjesëmarrjen e:

Gaspër Kokaj	Zëvendëskryetar
Igli Toska	Anëtar
Tomor Malaj	Anëtar
Pandeli Varfi	Anëtar

MORI NË SHQYRTIM ÇËSHTJEN ME:

OBJEKTI: Shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kryetarin e Komunës së Golajt të Qarkut të Kukësit.

BAZA LIGJORE: Neni 18 pika 4 i ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë".
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

KONSTATOI SE:

Me dekretin nr.237, datë 20.9.2001 "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për kryetar të Komunës Golaj", Presidenti i Republikës ka caktuar datën 14.10.2001 si datë për zgjedhjet për kryetar të kësaj komune.
Më datën 14.10.2001 u zhvilluan zgjedhjet në këtë komunë dhe KZQV Golaj mbi bazën e tabelave të rezultateve të 16 qendrave të votimit ka sjellë pranë KQZ-së tabelën e rezultateve përfundimtare të njësisë zgjedhore për kryetarin e komunës Golaj dhe mbi bazën e kësaj tabele ka shpallur dhe kryetarin e kësaj komune z.Adem Ahmet Lala.

PËR SA MË SIPËR:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 18 pika 1 i ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë",

V E N D O S I:

Të shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për kryetarin e Komunës Golaj të Qarkut Kukës, duke njohur si fitues z.Adem Ahmet Lala.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Zëvendës	Kryetari
Gaspër	Kokaj